



## Departamenti i Prokurimit

Prishtine:datë,17.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës [redacted] të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Bashkimi Meti”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rikonstruimi i rrugës Isa Kastrati”, me Nr. të Prok: 616 20 126 521 nxjerr:

### VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të “Bashkimi” të dt. 14.12.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “ **Rikonstruimi i rrugës Isa Kastrati**, me Nr. [redacted], kundër [Njoftimit për dhënie të Kontratës te AK –së, të datës 09.12.2020 te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
2. **Vërtetohet** Njoftimi i Vendimi te AK-se për dhënien e kontratës i publikuar me datë: 09.12.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që [te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit /aktivitetin e Prokurimit të ktheje ne Rivlersim];
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

Operatori Ekonomik "**Bashkimi Meti**" me datë 09.12.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Rikonstruimi i rrugës Isa Kastrati** me Nr. të Prok: **616 20 126 521**;

Autoriteti Kontraktues, me datë 17.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi juaj se jeni eliminuar pa te drejte nuk qendron, pasiqe eshte e verifikuar se ju nuk keni bere ndryshimet e te dhenave ne Paltformen elektronike ashtu si qe kerkohet me dispozita ligjore, respektivisht me neni 3.12.te Rregullave dhe Udhezuesit Operativ per prokurim Publik, sipas te cilit, citojme:

"Të gjithë Operatorët Ekonomik që janë të regjistruar dhe janë aktiv ne platformë të prokurimit elektronik, për çfarëdo ndryshimi të të dhënave të biznesit në Agjencion për Regjistrim te Bizneseve (ARBK) dhe Administratë Tatimore (ATK), qe për pasoje ka ndryshim/ndërrim të emërtimit dhe numrit te fiskal/biznesit, janë të obliguar që menjëherë vetë t'i përditësojnë të dhënat në platformë të prokurimit elektronik. Përditësimi i të dhënave bëhet në pajtim me udhëzimet e KRPP-së, nëpërmjet tavolinës ndihmëse ose udhëzuesit të publikuar në veb faqe të prokurimit elektronik".


-Pretendimi tjetër se tenderuesi i rekomanduar per kontrate ka bere shkelje ligjore, pasi qe ka dhene çmime me te ulta per fraksione krahasuar me marreveshjen, poashtu nuk eshte i bazuar, pasi qe komisioni profesional ka konstatuar se ne kete aktivitet nuk mund te zbatohen Rregullat per tenderet jonormalisht te ulet dhe per kete arsye nuk eshte kerkuar sqarim lidhur me çmimet nga asnje tenderues e as nga tenderuesi i rekomanduar per kontrate. Por, edhe sikur te vlenin keto Rregulla nuk do te mund te thuhej se ky tenderues ka bere shkelje ligjore, por do te kerkohej sqarim dhe Autoriteti Kontraktues do te vendoste ne baze te sqarimeve te te njejt.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë ka vendosur si ne dispozitiv.

### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

**Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij Vendimi.**



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit